

VENDIM
Nr.695, datë 10.11.2005

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE (TOKË ARË), QË PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE
NË QYTETIN E ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë arë), të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i varrezave publike në qytetin e Elbasanit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Elbasanit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 7182 m² tokë arë, të vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 13 825 350 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e njëzet e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga bashkia e Elbasanit.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale në shumën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet po nga bashkia e Elbasanit.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit nëntor 2005.
 7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe bashkia e Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE
PUBLIKE NË QYTETIN E ELBASANIT**

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/toke arë	Çmimi tokës/m ²	Vlera në total (lekë)
	Trashëgimtarët e familjes Haxholli	2502 m ²	1 925 lek	4 816 350
	Sanije Zenelhxha (Hoxholli) Dallëndyshe Ahmet Palloshi Fatos Ahmet Zenelhxha Dituri Ahmet Zenelhxha Robert Ahmet Zenelhxha Sulejman Latifi Luljeta Latifi Xhaferr Zenelhxha (Hoxholli) Ymer Zenelhxha Adriatik Zenelhxha Myzejen Pasmaqi Atlantik Zenelhxha Dashuni Harrja Fisnik Zenelhxha Pupulina Gjevori Drita Ballo Qemal Zenelhxha Sali Zenelhxha			

	Leonard Zenelhxha Durim Zenelhxha Xhemile Gora Fatmira Veizi (Cankja) Mit'hat Veizi Bashkëpronarët e familjes Vyshka Nashifer Ymer Meti Sabaudin Ymer Vyshka Gjinovefa Ymer Shuteriqi Fatush Ymer Vyshka Lavdiye Ymer Dimashi	4680 m ²	1925 lekë	9 009 000
--	---	---------------------	-----------	-----------

Gjithsej vlere totale e shpronësimit: 13 825 350 lekë.